



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKIAK
GRAMSH**

Nr. 2564 / Prot.
3

Gramsh, më 02.07. 2026

V E N D I M
Nr. 48 , datë 30/06/2026

**PËR VENDOSJEN E PLLAKËS PËRKUJTIMORE “SHTËPI BAZË LUFTE” NË
BANESËN E DËSHMORIT PETREF NAZIF ZHUPANI**

Këshilli Bashkiak, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur për vendosjen e pllakës përkujtimore “Shtëpi Bazë Luftë” në banesën e dëshmorit Petref Nazif Zhupani, si dhe dokumentacionin shoqërues, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligji nr.9270/2004 për “Sistemin e Adresave”, Ligji 112/2013 për “Dhënien e Dekoratave, Titujve të Nderit , Medaljet dhe Titujt Vendore të Nderit në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.109/2018 “Për Statusin e Dëshmorit të Atdheut”, VKM nr.861/2014, neni 33 , neni 34 , neni 36 dhe neni 47 i Rregullores së Funksionimit të Këshillit të Bashkisë , si dhe VKB nr. 38 datë 29/05/2026 Për miratimin e Udhëzuesit “për dhënien e Titujve Vendor të Nderit” .

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën për vendosjen e pllakës përkujtimore me mbishkrimin “Shtëpi Bazë Luftë” në banesën e dëshmorit Petref Nazif Zhupani, në shenjë nderimi dhe vlerësimi për kontributin e tij dhe të familjes së tij në Luftën Nacionalçlirimtare.
2. Vendosja e pllakës të realizohet në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga institucionet përgjegjëse.
3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë dhe strukturat përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve ligjore.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Xhulia GJINI



KRYETARI I KËSHILLIT

Enis ZANI